

Prishtinë, 21.06.2007

Në përputhje me kompetencat e caktuara në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji nxjerr:

## **Udhëzim i Përkohshëm I\_04\_2007 për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore**

### **Kapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1 Fushëveprimi dhe qëllimi**

- 1.1 Ky udhëzim është nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) me qëllim të krijimit të një mekanizmi të mbledhjes nga ana e ZRRÉ-së të informatave financiare, teknike dhe të konsumatorëve nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për qëllime rregullative, më me rëndësi për definimin e të ardhurave të lejuara që i rikthehen nga tarifat e rregulluara të licencuarit.
- 1.2 Neni 13 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë siguron për ZRRÉ-në të drejtën që të kërkojë nga secila ndërmarrje energjetike apo autoritet publik informata, të dhëna dhe dokumente, përfshirë informatat konfidenciale, të domosdoshme për realizimin e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të saj.
- 1.3 Kjo kompetencë zbatohet përmes kushteve të licencës dhe, veçanërisht, kërkesës së të licencuarit që të përgatisë dhe mirëmbajë llogaritë e ndara, si dhe të dhënat tjera teknike dhe të konsumatorëve për bizneset e ndara.
- 1.4 Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore, në baza vjetore, do të plotësojnë raportin rregullativ në përputhje me këtë udhëzim të nxjerrë nga ZRRÉ-ja; është kërkesë mandatore (e detyrueshme) që përveç pasqyrave (deklaratave) financiare “statutore” edhe pasqyrat (deklaratat) rregullative financiare duhet të auditohen nga një auditor i jashtëm i pavarur.
- 1.5 Udhëzimi mbi raportimin rregullativ do të:
  - a) Përcaktojë procesin për kompletimin dhe dorëzimin e raportimit rregullativ nga ndërmarrjet e ngrohjes qendrore;
  - b) Detajojë informatat të cilat duhet të përfshihen në raportimin rregullativ;
  - c) Përmbajë shpjegime dhe udhëzime për të licencuarit se si të përgatisin dhe kompletojnë raportimin rregullativ, veçanërisht parimet të cilat duhet të drejtojnë alokimin e të ardhurave, kostove (shpenzimeve), asetëve dhe detyrimeve (borxheve).
- 1.6 Udhëzimi mbi raportin rregullativ do të specifikojnë:

- a) Formën e pasqyrave (deklaratave) që përfshihen në raportimin rregullativ, përfshirë, por jo kufizuar, pasqyrën e fitimit dhe humbjeve (të hyrave dhe shpenzimeve), bilancin e gjendjes, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, dhe pasqyrën e të ardhurave dhe kostove (shpenzimeve), asetet, faturimin dhe mbledhjen e pagesave, dhe shpenzimet e investimit si dhe pasqyrën teknike;
- b) Natyrën dhe përmbajtjen e pasqyrave (deklaratave) rregullative, përfshirë informatat mbi tipet e veçanta të të ardhurave, kostove (shpenzimeve), asetëve apo detyrimeve të ngarkuara për aktivitete specifike si dhe informata teknike dhe të konsumatorëve;
- c) Parimet e kontabilitetit (përfshirë bazat për alokimin e kostove), dhe detajet për formulimin e informatës teknike të kërkuar.

1.7 Informata e dhënë ZRrE-së në përputhje me këtë Udhëzim do të përdoret këto qëllime:

- a) të sigurojë alokimin e drejtë të të ardhurave, kostove (shpenzimeve) dhe asetëve midis aktiviteteve të rregulluara dhe jo të rregulluara;
- b) t'i mundësojë ZRrE-së të përcaktojë të ardhurat e lejuara për të licencuarit dhe rishikimin nga ana e ZRrE-së të tarifave të rregulluara të propozuara nga të licencuarit;
- c) të masë performancën financiare dhe teknike të ndërmarrjeve energjetike në krahasim me parashikimet;
- d) qëllime tjera të tilla që mund të kërkohen për plotësimin e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të ZRrE-së.

## **Kapitulli 2**

### **Procedurat e Raportimit Rregullativ në Ngrohjen Qendrore dhe Përmbajtja e të Dhënave Financiare dhe Teknike**

#### Neni 2

##### Obligimet për Dorëzimin e Raportimit Rregullativ

2.1 Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore janë të obliguara që të përgatisin dhe të dorëzojnë raportimin rregullativ në përputhje me këtë Udhëzim; ky obligim veçanërisht u ngarkohet:

- a) ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore të cilave u kërkohet të propozojnë tarifën e rregulluar për aprovim, dhe
- b) ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore të cilat, pavarësisht nëse tarifën e tyre janë të rregulluara apo jo, mbajnë një pozitë dominuese në një apo më shumë aktivitete energjetike në territoret përkatëse që mbulojnë.

#### Neni 3

##### Afatet kohore dhe Forma e Dorëzimit

3.1 Pasqyrat (deklaratat) rregullative, pos nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga ZRrE-ja, do të përgatiten për periudhën prej 15 tetorit 2006 deri më 15 prill 2007, i cili përfshin gjithë sezonin e ngrohjes 2006 / 2007.

3.2 Raportimi rregullativ do të dorëzohet brenda afatit të caktuar në Planin Implementues dhe Orarin – Rishikimi i Çmimeve të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore (deri më 29 qershor); dorëzimi do të jetë në formë elektronike dhe në letër nënshkruar nga personi i autorizuar i

ndërmarrjes së ngrohjes qendrore dhe nga auditori në përputhje me Nenin 1.4. Pasqyrat (deklaratat) rregullative mostër mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të ZRrE-së [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

- 3.3 Pasqyrat (deklaratat) që i përmban Raportimi Rregullativ do të përgatiten në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës, Rregulloren 2001/30 mbi Regjimin e Raportimit Financiar të Bizneseve dhe me këtë Udhëzim.
- 3.4 Informata e prezantuar në raportimin rregullativ duhet të jetë e kuptueshme, e besueshme dhe relevante; kur të jetë e aplikueshme, pasqyrat do të përkrahen me ndarjen (detalizimin) e pozicioneve të caktuara dhe/ose me dokumentacionin përcjellës për të justifikuar dhe qartësuar informatën e dhënë.
- 3.5 Në rast kur raportimi rregullativ i dorëzuar dhe dokumentacioni përcjellës nuk janë në pajtim me dispozitat e këtij Udhëzimi dhe/ose jo complete, ZRrE-ja do ta refuzojë (hedhë poshtë) dhe do ta kthejë për kompletim dhe ri-dorëzim. Periudha e ri-dorëzimit nuk do të jetë më pak se 7 ditë kalendarike nga data kur ZRrE ka dërguar njoftimin me shkrim në formë komentesh.

#### Neni 4 Verifikimi dhe Auditimi

- 4.1 ZRrE do të ketë të drejtën e verifikimit, me iniciativë të veten, të informatave të dhëna në raportimin rregullativ, duke pasur qasje në llogaritë e ndërmarrjes së ngrohjes qendrore dhe të dhënat tjera teknike dhe të konsumatorëve.
- 4.2 Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore janë të obliguara të zbulojnë çdo informatë që anëtari i stafit të ZRrE-së apo përfaqësuesi i saj e kërkon, duke përfshirë edhe informatën e fshehtë financiare.
- 4.3 Informatat e dhëna në raportimin rregullativ duhet të jetë të audituara në mënyrë adekuate nga një auditor i jashtëm i pranuar / aprovuar nga ZRrE-ja. Ndërmarrja e Ngrohjes Qendrore është përgjegjëse të sigurojë një aprovim të tillë para se të përgatitet dhe dorëzohet raportimi rregullativ.

#### Neni 5 Ndarja e aktiviteteve

Në realizimin e raportimit rregullativ, kërkohet që ndërmarrjet e ngrohjes qendrore të ndajnë informatat dhe të dhënat për aktivitetet e Prodhimit (Gjenerimit) të Ngrohjes, dhe Distributimit dhe Furnizimit me ngrohje, siq është e aplikueshme.

#### Neni 6

##### Përmbajtja e Raportimit Rregullativ

Raportimi rregullativ i dorëzuar nga Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore do të përmbajë pasqyrat (deklaratat) financiare “statusore”, dhe pasqyrat (deklaratat) rregullative; përshkrimi i detajuar i të cilave është dhënë më poshtë:

- 6.1 Pasqyrat (deklaratat) financiare “statusore” janë ato pasqyra financiare të përgatitura dhe dorëzuara në përputhje me legjislacionin në Kosovë; pasqyrat financiare “statusore” përfshirë anekset me zbatimin e detajuar të pozicioneve, raportin e auditorit të pavarur, për vitin e kaluar kalendarik, janë dhënë më poshtë:

- a) Bilanci i gjendjes,
- b) Pasqyra e Profitit/Humbjes (të hyrave dhe shpenzimeve),
- c) Pasqyra e Rrjedhës së parasë,
- d) Raporti i Auditorit të Pavarur, dhe
- e) Anekset me zbërthimin e detajuar të pozicioneve kryesore që i përmbajnë pasqyrat financiare “statusore”.

6.2 Pasqyrat (deklaratat) rregullative, të cilat do të jenë të kompletuara në përputhje me këtë Udhëzim, dhe duke përdorur pasqyrat rregullative mostër në Aneksin 1, janë dhënë më poshtë:

- a) Pasqyrën e Aseteve Operative,
- b) Pasqyrën e Kostove dhe të Ardhurave vjetore
- c) Pasqyrën e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave,
- d) Pasqyrën e Shpenzimeve Investive,
- e) Pasqyrën teknike, dhe
- f) Pasqyrat Mbështetëse.

### **Chapter 3**

#### **Udhëzime për Plotësimin e Pasqyrave (Deklaratave) Rregullative**

##### Neni 7

Udhëzimet për plotësimin e Pasqyrave Rregullative, japin metodat e regjistrimit të të dhënave dhe përgatitjen e pasqyrave të kërkuara nga ZRrE-ja prej Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore. Gjatë përgatitjes së pasqyrave rregullative, Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore duhet të i përmbahen këtyre udhëzimeve.

##### Neni 8

Pasqyrat Rregullative përgatiten për aktivitetet vijuese të ngrohjes qendrore të ndarë në grupe:

- a) G1 - Prodhimi i ngrohjes
- b) G2 – Distribuimi dhe furnizimi me ngrohje

##### Neni 9

Pasqyrat Rregullative strukturohen në grupet vijuese:

- a) Pasqyra e Aseteve Operative – A G1,G2;
- b) Pasqyra e Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore – B-G1,G2;
- c) Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave – C-G2;
- d) Pasqyra e Shpenzimeve Investive – D-G1,G2;
- e) Pasqyra Teknike – E-G1,G2; dhe
- f) Pasqyrat Mbështetëse
- g)

##### Neni 10

Udhëzime për Plotësimin e Pasqyrës (Deklaratës) së Aseteve Operative – Pasyra A-G1, G2

10.1 Pasqyra e Aseteve Operative përfshin asetet që përdoren për të kryer një aktivitet të caktuar të ngrohjes qendrore, pra asetet fikse, dhe asetet jo të prekshme (patenta, etj), dhe ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Asetet Drejtpërdrejt të Përcaktuara (Angazhuara) – të cilat marrin pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e aktiviteteve të veçanta të ngrohjes qendrore (G1 ose G2), dhe qartë mund të përcaktohen si asete të një aktiviteti të caktuar ngrohjes qendrore.
- b) Asetet Mbështetëse – asetet që shërbejnë për të kryer më shumë se një aktivitet, dhe që nuk mund të përcaktohen qartë si asete të një aktiviteti të ngrohjes qendrore.
- c) Asete të Përbashkëta – asetet që shërbejnë për të kryer aktivitete të ngrohjes qendrore (grupet G1 dhe G2), si dhe aktivitete të tjera jo të lidhura me ngrohjen qendrore.

10.2 Asetet operative nuk përfshijnë:

- a) Projekte investimi jo të prekshme në vijim,
- b) Paradhëniet e paguara për asetet afatgjata jo të prekshme
- c) Projekte investimi të prekshme në vijim,
- d) Paradhënie të paguara ndaj aserve të prekshme afatgjata
- e) Rregullimi i çmimit të blerjes së aseteve,
- f) Investimin financiar, dhe
- g) Vlerën e sendeve të blera në lizing (qeranë) financiare, që nuk është mbajtur në llogaritë kontabël.

10.3 Asetet operative deklarohen sipas vlerave vijuese:

- a) Çmimin e blerjes me koston historike,
- b) Zhvlerësimi i akumuluar,
- c) Vlera sipas librave kontabël, dhe
- d) Koston (Çmimin) zëvendësuese në vlerën e tregut

10.4 Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së Pasqyrës së Aseteve Operative për çdo aktivitet të ngrohjes qendrore:

a) Asetet Drejtpërdrejt të Përcaktuara (Angazhuara):

a.1) Prodhimi i ngrohjes:

- Kufizimi:
  - Fillimi: sistemet e përdorur për pranimin e karburantit
  - Fundi: pika e dërgimit të ngrohjes në rrjetin e distribuimit të ngrohjes.
- Artikujt kryesorë për t'u përfshirë:
  - Kaldajat (kaldajat me mazut ose me dizel)
  - Oxhaku,
  - Shkëmbyesit të nxehtësisë në ngrohtore,
  - Pompa qarkulluese në ngrohtore,
  - Sisteme për trajtimin e karburantit,
  - Sisteme të menaxhimit të ujit, përfshirë trajtimin kimik të ujit,
  - Sisteme ambientale për kaldajat,

- Sisteme për prodhimin e elektricitetit për konsum të brendshëm në ngrohore (p.sh. gjeneratorët e energjisë elektrike).

a.2) Distribuimi dhe Furnizimi me ngrohje:

- Kufizimi:
  - Fillimi: pika e kalimit të ujit të ngrohët prej ngrohtores në sistemin e distribuimit të ngrohjes,
  - Fundi: pika e kalimit të ujit të ngrohët në sistemin e konsumatorit ose pika matëse.
- Artikujt kryesorë për t'u përfshirë:
  - Tubacionet e ujit të ngrohët,
  - Rrjeti i distribuimit,
  - Tubacionet kryesore të furnizimit (tubacionet në rrjetin primarë),
  - Stacionet transferuese – Nënstacionet,
  - Sistemet matëse dhe kontrolluese.

b) Asetet Mbështetëse

Asetet mbështetëse janë asetet e përdorura për prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin e ngrohjes.

- Artikujt kryesorë që do përfshihen nën asetet mbështetëse:
  - Ndërtesa dhe struktura inxhinierike (si p.sh. njësitë prodhuese),
  - Softverë,
  - Hardverë,
  - Sisteme të informacionit gjeografik,
  - Pajisje, inventari,
  - Studime, projekte, shërbime ligjore dhe këshilluese

a) Asetet e Përbashkëta

Asetet e përbashkëta përbëhen nga prona që përdoren për të kryer aktivitete të lidhura me ngrohjen qendrore dhe për kryerjen e aktiviteteve të tjera jo të lidhura me ngrohjen qendrore.

- Artikujt kryesorë:
  - Toka,
  - Ndërtesat e përbashkëta për zyra,
  - Garazhe,
  - Sisteme të informimit të kompanisë,
  - Artikuj të tjerë pronësorë.

Neni 11

Udhëzime për plotësimin e Pasqyrës (Deklaratës) së Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore – Raporti B-G1,G2

- 11.1 Pasqyra e Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore përbëhet nga të ardhurat dhe shpenzimet e lejueshme, të strukturuar sipas pozicioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore, si dhe sipas llojit të aktiviteteve të ngrohjes qendrore (grupet G1, G2)

11.2 Shpenzimet e lejueshme nënkupton shpenzimet e nevojshme për të kryer aktivitetin e ngrohjes qendrore dhe përfshijnë:

- a) Shpenzimet e burimeve primare të energjisë (karburantet),
- b) Shpenzimet e energjisë së konsumuar (elektricitet, ujë),
- c) Shpenzimet e personelit – pagat plus kontributet e pensionit dhe taksa të tjera të pagueshme prej kompanisë,
- d) Shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemit,
- e) Zhvlerësimin e regjistruar të aseteve fikse,
- f) Interesi nga huat e marra dhe tarifat e bankës si dhe shpenzime të tjera,
- g) Shpenzimet të tjera që mund të jenë të lidhura direkt me aktivitetin e ngrohjes qendrore, si blerja e shërbimeve të ndryshme të jashtme nga kontraktues të jashtëm, etj., dhe
- h) Shpenzime të justifikuara financiare dhe të jashtëzakonshme.

11.3 Kostot (shpenzimet) e lejueshme nuk përfshijnë:

- a) Subvencionet,
- b) Shpenzimet e refuzuara prej autoriteteve tatimore,
- c) Marzhat nga qiraja (lizingu),
- d) Shpenzimet për rezervat të lëna mënjanë dhe të liruara,
- e) Pagesat e qerasë për vlerën e artikujve që nuk janë regjistruar në llogaritë kontabël, dhe
- f) Shpenzime të tjera financiare dhe të jashtëzakonshme.

11.4 Struktura themelore e ndarjes së shpenzimeve përbëhet nga:

- a) Shpenzimet operative
  - Pjesa e ndryshueshme (variabile)
  - Pjesa e pandryshueshme (fikse)
- b) Zhvlerësimi i aseteve fikse

11.5 Ndarja e shpenzimeve sipas nivelit të pjesëmarrjes në kryerjen e aktiviteteve specifike të ngrohjes qendrore:

- a) Shpenzimet Drejtpërdrejt të Përcaktuara – të cilat shkaktohen drejtpërdrejt për kryerjen e një aktiviteti specifik të ngrohjes qendrore (G1 ose G2), dhe mund të përcaktohen qartë shpenzim për një aktiviteti të caktuar të NQ
- b) Shpenzime Mbështetëse – të cilat shkaktohen për të kryer më shumë se një aktivitet të ngrohjes qendrore dhe janë të lidhura me menaxhimin e drejtpërdrejtë të prodhimit të ngrohjes, distribuimit dhe furnizimit me ngrohje; këto shpenzime nuk mund t'i caktohen vetëm një aktiviteti të veçantë të ngrohjes qendrore.
- c) Shpenzime të Përbashkëta – këto përfaqësojnë shpenzimet e përbashkëta të lidhura me administrimin dhe menaxhimin e biznesit të kompanisë në tërësi; këto kosto përfitohen për kryerjen e aktiviteteve të ngrohjes qendrore dhe aktiviteteve që nuk kanë të bëjnë me ngrohjen qendrore.

11.6 Të ardhurat e lejueshme përfshijnë: shitjet prej aktiviteteve të caktuara të ngrohjes qendrore, p.sh. shitjet e ngrohjes dhe shërbimet e bëra, si dhe të ardhura të tjera që rrjedhin nga një aktivitet i caktuar.

11.7 Të ardhurat e lejueshme nuk përfshijnë të ardhurat nga aktivitete që nuk kanë të bëjnë me ngrohjes qendrore, të ardhurat nga shitja e aseteve të prekshme dhe jo të prekshme dhe inventarit, si dhe të ardhura nga dhënia me qira e pronës.

#### Neni 12

Në Pasqyrën (Deklaratën) e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave – Pasqyra C-G2, janë dhënë të dhënat për faturimin dhe arkëtimin e pagesave për ngrohjen e furnizuar konsumatorëve në sezonin e caktuar të ngrohjes.

#### Neni 13

Udhëzime për plotësimin e Pasqyrës (Deklaratës) së Shpenzimeve të Investimit – Pasqyra D-G1,G2

- 13.1 Në këtë pasqyrë futen shpenzimet për investimet aktuale dhe të planifikuara të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore për vitin aktual dhe për katër (4) vitet e ardhshëm.
- 13.2 Pasqyra përbëhet nga investimi i bërë direkt në aktivitetin e ngrohjes qendrore - prodhimin, distribuimin dhe furnizimin e ngrohjes.
- 13.3 Gjithashtu, në pozicionin “të tjera”, pasqyra përmban shpenzime investimi që i përkasin pronës mbështetëse dhe të përbashkët, si dhe aktiviteteve që nuk i takojnë ngrohjes qendrore; paraqitje e detajuar e këtij pozicioni duhet të jepet si informacion plotësues i raportit.
- 14.4 Shpenzimet e Investimit përmbajnë, mes të tjerash, edhe shpenzimet për paradhënie dhe/ose për ndërtimin në vijim. Në anën tjetër, nuk përfshihen shpenzimet për investime financiare.

#### Neni 15

Udhëzime për plotësimin e Pasqyrës (Deklaratës) Teknike - Pasqyra E-G1,G2

- 15.1 Kjo pasqyrë përmban pjesët vijuese: Të Dhënat Teknike të Përgjithshme; Bilanci Energjisë (Prodhimit të Ngrohjes); Bilanci i Ngrohjes (Furnizimit); dhe Konsumi i Karburanteve.
- 15.2 Të Dhënat Teknike të Përgjithshme përmbajnë si vijon:
  - a) Kapaciteti i instaluar i ngrohjes – d.m.th. kapacitetin e plotë të ngrohjes së instaluar në ngrohtore, pavarësisht prej gjendjes aktuale teknike,
  - b) Kapaciteti i disponueshëm i ngrohjes – kapaciteti i plotë i ngrohjes në gjendje pune (i gatshëm për operim),
  - c) Gjatësia e rrjetit të distribuimit – gjatësia e rrjetit primar (tubacioni)
  - d) Numri i nënstacioneve – numri total i nënstacioneve të instaluar në sistemin e ngrohjes qendrore / distribuimit, dhe
  - e) Numri i nënstacioneve aktive – numri total i nënstacioneve përmes të cilëve aktualisht furnizohen konsumatorët.
- 15.3 Bilanci i Energjisë (Prodhimit të Ngrohjes) përbëhet nga:
  - a) Energjia e futur nga karburanti – d.m.th. energjia totale e karburantit në MWh e përdorur për prodhimin e ngrohjes
  - b) Prodhimi bruto i ngrohjes – ngrohja totale e prodhuar prej njësisë prodhuese
  - c) Prodhimi neto i ngrohjes – sasia e ngrohjes e dërguar në rrjetin e distribuimit, e matur në pikën e ndarjes midis prodhimit të ngrohjes dhe rrjetit të distribuimit.
  - d) Konsumimi vetanak – sasia e ngrohjes së përdorur për konsumim vetanak në ngrohtore, si p.sh. ngrohja për sistemet ndihmëse, ngrohja e hapësirave të godinave, etj.



- e) Efikasiteti total i ngrohtores – si raport midis prodhimit neto të ngrohjes dhe futjes së karburantit; **Formula: Efikasiteti i ngrohtores = (Prodhimin neto të ngrohjes / Energjinë e futur nga karburanti) \* 100**
- f) Konsumi i ujit – sasia totale e ujit të thjeshtë i përdorur për përgatitjen e ujit të trajtuar (ujë i trajtuar për (ri) mbushjen e sistemit),
- g) Konsumi i elektriciteti– elektriciteti i konsumuar në ngrohore dhe në rrjetin e distribuimit, si p.sh. elektriciteti për para-ngrohjen e mazutit, për kaldajën, për vënien në punë të pompave kryesore qarkulluese për rrjetin primarë, etj.

#### 15.4 Bilanci i Ngrhjes (Furnizimit) përbëhet nga:

- a) Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit – sasia e ngrohjes së matur në pikën ndarëse midis prodhimit të ngrohjes dhe rrjetit të distribuimit; korrespondon me prodhimin neto të ngrohjes
- b) Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje – sasia e ngrohjes e dërguar në nënstacionet e konsumatorëve, e matur në pikën matëse, pikën ndarëse midis rrjetit primarë dhe sekondarë
- c) Humbjet në distribuim [MWh] – diferenca midis sasisë së ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit dhe ngrohjes së furnizuar konsumatorëve; **Formula: Humbjet në distribuim = Hyrje e ngrohjes – Furnizim i ngrohjes**
- d) Humbjet në shpërndarje [%] – **Formula: Humbjet në shpërndarje = [(Ngrhja e futur në rrjetin e distribuimit – Furnizim i ngrohjes) / Ngrhja e futur në rrjetin e distribuimit] \* 100**

#### 15.5 Të dhënat e konsumatorëve përbëhen nga si vijon:

- a) Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes – shuma e kapacitetit të dakorduar për çdo nënstacion konsumatorësh (e përcaktuar si kërkesë për ngarkesë maksimale për temperaturën e jashtme të dizajnuar),
- b) Hapësira totale e ngrohur – hapësira totale e ngrohur e furnizuar me ngrohje për çdo grup konsumatorësh (aktualisht: shtëpiakë, komercialë dhe institucionalë)
- c) Kërkesa specifike për kapacitet të ngrohjes –kërkesa e vlerësuar (llogaritur) e kapacitetit të ngrohjes për metër katror (përcaktuar si kërkesë për ngarkesë maksimale për metër katror për temperaturën e jashtme të dizajnuar) për çdo grup konsumatorësh (aktualisht: shtëpiakë, komercialë dhe institucionalë)
- d) Orët nominale të ngarkesës së plotë – e përllogaritur si raporti midis ngrohjes vjetore të furnizuar tek konsumatorët dhe kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes për çdo grup konsumatorësh,
- e) Kërkesa për ngrohje – kërkesa e përllogaritur për ngrohje për çdo grup konsumatorësh; **Formula: Kërkesa për ngrohje = Kërkesa specifike për kapacitet të ngrohjes \* Hapësira totale e ngrohur \* Orët nominale të ngarkesës së plotë.**

#### 15.6 Konsumimi i karburanteve është si vijon:

- a) Sasia e karburantit të konsumuar në tonë
- b) Vlera e Ulët e Ngrhjes – sasia e ngrohjes së dobishme e fituar prej djegies së një toni karburant
- c) Energjia nga karburant – **Formula: Energjia në karburant = Sasia e karburantit \* Vlera e Ulët e Ngrhjes**

Neni 16

Pasqyrat (deklaratat) Mbështetëse duhet të përmbajnë:

- a) Raporte ditore dhe mujore të prodhimit të ngrohjes,
- b) Raporte mujore mbi regjistrimin dhe analizat e furnizimit të matur të ngrohjes nëpër nënstacione,
- c) Bazën e të dhënave të konsumatorëve të azhuruar, dhe
- d) Çdo dokument tjetër të bashkangjitur që nevojitet për të mbështetur dhe sqaruar deklaratat rregullative të paraqitura

Neni 17  
Gjuha Zyrtare e Udhëzimit

Ky Udhëzim lëshohet në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. Në rast të ndonjë kontesti versioni në gjuhën shqipe do të mbizotërojë.

Neni 18  
Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzim do të hyj në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi i ZRrE-së dhe nga data e publikimit në faqen zyrtare të internetit të ZRrE-së.

Bordi i ZRrE-së

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, Kryesues;

\_\_\_\_\_  
Mr. Theranda Beqiri, anëtar;

\_\_\_\_\_  
Dr. Nysret Avdiu, anëtar;

\_\_\_\_\_  
Naim Bejtullahu, anëtar